

Tiranë, 31. 03. 2017

Nr. Prot. _____

LETËR REFERENCE

Nëpërmjet kësaj Letër Reference, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) shpreh vlerësimin për bashkëpunimin në interes të të drejtave të fëmijëve me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori).

MPB ka bashkëpunuar me Observatorin në zbatimin e nismave të ndryshme në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

MPB ka bashkëpunuar me Observatorin në zbatimin e nismës “Çdo fëmijë në shkollë” që prej vitit 2013 me synim identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve në moshë të detyrimit shkollor si edhe parandalimin e braktisjes së shkollës. Nisma synon ngritjen e mekanizmave të mjaftueshme që çdo fëmijë i moshës së detyrimit shkollor të ndjekë shkollën 9-vjeçare. Falë partneritetit me Observatorin, në zbatim të nismës “Çdo fëmijë në shkollë” është mundësuar pilotimi i zbatimit të Urdhërit të Përbashkët Treministror “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor (U3M) në Durrës, nëpërmjet:

1. Bashkëpunimit ndër- ministror dhe ndër- institucional për të zbatuar rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në U3M për të regjistruar në shkollë të të gjithë fëmijët e moshës së detyrimit shkollor.
2. Angazhimit ndër- institucional për të identifikuar, verifikuar në terren dhe regjistruar fëmijët në shkollë, sipas listave të fëmijëve që i përkasin moshës së detyrimit shkollor- sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe nxënësve që janë në shkollë sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS).

MPB ka mbështetur nismat e realizuara nga Observatori për eksplorimin më në detaje të çështjes së martesave nën moshë dhe efekteve të saj në çështjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të miturve nga realizimi i martesës nën moshë për efekte trafikimi, shfrytëzimi ose çdo forme tjetër abuzimi. Observatori është bërë pjesë e fushatave për promovimin e policimit në komunitet dhe ndërgjegjësimin për shërbimin policor në jetën e fëmijëve, të rinjve, familjeve dhe shoqërisë në tërësi.

Deri tani bashkëpunimi me Observatorin ka qenë i suksesshëm dhe me angazhime konkrete.

Me respekt,

Znj. Elona Gjebrea,
Zv. Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

